

VENDIM
Nr.36, datë 27.1.1997

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT “MBËSHTETJE PËR FUQIZIMIN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES SË BIMËVE” DHE FINANCIMIN E TIJ ME GRANT TË QEVERISË HOLANDEZE

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projektit “Mbështetje për fuqizimin e shërbimit të mbrojtjes së bimëve” dhe financimin e tij me grant nga Qeveria holandeze.
 2. Financimi për këtë projekt për shumën deri 2.5 milionë gulden holandez (1.45 milionë US \$) do të mbulohen nga Qeveria holandeze.
 3. Autorizohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, ose i autorizuari i tij, të nënshkruajë letrën e angazhimit për projektin në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.
 4. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e projektit përkatës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi